

PROCESVERBAL –
Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: *Ndertim Sistem Kanalizimesh dhe Impjant Trajtimi te Ujerave te Ndotura ne Qytetin Bulqize (Lagja e Re).*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Pune Ndertimi 45000000-7:45232411-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 215 568 250(Dyqind e pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) **leke pa TVSH.**(Sipas preventivit të hartuar nga subjekti projektues).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Bulqize ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.2.2 Operoret ekonomik duhet te paraqesin bilancet vjetore per 3 vitet e fundit financiare të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* (i ndryshuar).

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operoret ekonomik duhet te paraqesin kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrata tatimore pergjate tre viteve te fundit 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit te kontrates qe po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e

renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, konkretisht : **107 784 125 (Njëqindsetatëmilioneshtatëqindetëdhjetekatërmijënjëqindënjzetepese) leke pa t.v.sh**

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht : **431 136 500 (Katërqind e tridhjetënjë milion e njëqindtridhjetëgjatëmijë e pesëqind) leke pa t.v.sh** , datë e përlogaritur **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarje
 - Situacionin përfundimtar,
 - Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;

- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posacme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

a) Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe

b) Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalish sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuar me ligj si më poshtë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NP-1 A	Punime gërmimi në tokë.
NP-2 B	Ndërtime civile dhe industriale
NP-4 C	Punime ne rruge
NP-5 A	Punime nentoksore, ure e vepra arti
NP-7 E	Punime ujesjellesa, kanalizime etj.
NP-12 C	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

NS- 1 A	Punime per prishjen e ndertimeve
NS- 4 A	Punime rifiniture murature, etj
NS- 6 A	Sinjalistika rrugore jondricuese
NS- 9 B	Punime strukturore speciale
NS- 18 B	Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe VKM Nr. 42 date 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore....,Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 1 - A	(Punime gjërmimi në tokë)	Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjërmime në tokë, p.sh. “ <i>Gërmim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne toke</i> ”, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet	0-20

		fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.	
N.S 1- A	(Punime për Prishjen e Ndërtimeve)	Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune të kategorisë prishje punimesh, të cilat shtrajnë të nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-1.	0-20
N.S -2- A	(Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre);	Ne preventiv është parashikuar sistem i mbrojtjes nga zjarrit, Sistemi hidraulik ne ambjentin teknik te përbashkët, rrjetin sanitar dhe MNZ, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Përfshin konkretisht mbrojtjen antizjarr dhe sistemet si dhe punimet / pajisjet hidrosanitare .	0-20
N.S-4 - C	(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese);	Ne preventive dhe projekt teknik janë parashikuar punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese Gjithashtu kemi ristrukturim te muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet gjithashtu vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dymve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.	51-100
NS 18 - A	(Punime topogjeodezike)	Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike (ndërtim), qe lidhen ngushtesisht me natyren teknike te realizimit të objektit është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.	0-20

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 104 persona**. Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me kohë të plotë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Prill 2022-Shtator 2022**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Prill-Shtator 2022**.

Argumentim: *Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për njëpunësim të paktën 104 (njëqind) persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe dëshmi të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë Drejtues Teknik në licencë pajisur me kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt te vertetuar me, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa (për muajt Prill 2022-Shtator 2022) si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 2 (dy)
- Inxhinier Hidroteknik 2 (dy)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog 1 (një)

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

(Per Inxhinierin e mjedisit OE te paraqese certificate per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis dhe licence per Vleresimin e ndikimit ne Mjedis (nje)

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diploma e inxhinierëve dhe kontrata pune e vlefshme.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit përmbledhës te Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST.

Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për (për muajt Prill 2022-Shtator 2022).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar janë përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierët e kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si inxhinierët e kërkuar është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Me

këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre.

Kërkesa për inxhinierin e mjedisit është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, në nenin 20 pika 4 ku parashikohet se: Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, dhe sipas shtojca II, Pika 10/b) ku parashikohet se: Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat.

Gjithashtu, Bazuar në Nenin 39, pika 7, germa “c”, të VKM 285 datë 29.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet: “Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: Operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës”.

Nga sa më sipër, kërkesa është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Gjithashtu dhe mbështetur në të gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi i cili rregullon procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, konkretisht, sipas pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar është miratuar VKM Nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, ku përcaktohen rregullat dhe veprimet që duhet të ndërmerren nga zhvilluesit dhe autoritetet kompetente për të përmbushur kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e VNM-së është arsyetuar se duhet një kapacitet i tillë.

Domosdoshmëria për disponimin e Inxhinierit të Mjedisit kërkohet edhe në përputhje me ligjin nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ku në nenin 21 citohet, “Punëmarrësi duhet që, në përputhje me formimin e tij, me instruksionet e dhëna nga punëdhënësi dhe me manualët e udhëzimit dhe rregulloret teknike duhet të (i) bashkëpunojë me punëdhënësin/ punëmarrësin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve dhe (ii) derisa të jetë e nevojshme për t’i lejuar punëdhënësit të sigurojë që **mjedisit dhe kushtet e punës të jenë të sigurt dhe pa rrezik për sigurinë dhe shëndetin**, brenda fushës së tyre të veprimtarisë” .

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit të punimeve.

- Inxhinieri i Ndërtimit është i nevojshëm për punimet për strukturat prej betoni, për muret, pusetat, kanalin, . Inxhinieri i ndërtimit do të jete përgjegjes per kontrollin e cilesise te te gjithe betonit. Materialet dhe mjeshteria e perdorur ne punimet e betonit duhet te jete e nje cilesie sa me te larte qe te jete e mundur, prandaj vetem personel me eksperience dhe aftesi te plote ne kete kategori punimesh do te punohesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.
- Inxhinieri Mekanik është i nevojshëm për prodhimin dhe instalimin e konstruksioneve metalike, te shkalleve, shkarkuesve, nspektimin e mjeteve të rënda me të cilat do të kryhen proceset e punës për gërmimin .

- Inxhinieri Hidroteknik është i nevojshëm për punimet e ndertimit të kanalit . Gjatë punimet e tjera me karakter hidroteknik.
- Inxhinier Gjeodet ose topograf është kërkuar për arsye të zbatimit të punimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt, duke qene se behet fjale per ndertimin e nje kanali ujrave te zeza ne te cilin ujrat leviz me veterrjedhje dhe realizimi i kuotave te projekti eshte tejet i rendesishem per funksionimin e vepres.
- Inxhinier Mjedisi , Profili trajtim uji duhet mbasi kemi te bejme me trajtim te ujrave te ndotura ne nje abient mes lagje te qytetit
- Tekniku i Ndertimit eshte i nevojshem per organizimin e grupeve te punes e makinerive ne kantier per rritjen e eficenses dhe zbatimin e punimeve sipas afatit kohor te kerkuar nga investitori.
- Manovratori është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda, duke qene se behet fjale per ndertimin e nje kanali te ujrave te zeza ne te cilin uji leviz me veterrjedhje dhe realizimi i kuotave te projektit eshte tejet i rendesishem per funksionimin e vepres, cka e ben te domosdoshem perdorimin e mjeteve te germimit nga personel i kualifikuar.
- Drejtuesi i mjetit është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion, kamioncinë, e automjet teknologjik i pajisur me sisteme kamerash, me automjet teknologjik i pajisur me pompe pastrimi, etj.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim të paktën 32 persona mesatar duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë

autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport) zëri fuqi punëtorë ze rreth 20% të kostos.

2.3.6.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë nëpërmjet listëpagesave dhe kontratave të punës se ka të punësuar në shoqëri **45 (dyzet e pesë) punëtorë krahu**.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar *punonjës të kualifikuar* për realizimin e zërave të veçanta të punimeve, të pajisur me Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial ose ekuivalent, minimalisht si më poshtë:

- 2 (dy) Teknik ndertimi
- 2 (dy) hidraulik
- 2 (dy) montues tubash
- 2 (dy) karpentier
- 1 (nje) hekurkthyes
- 2 (dy) mekanik/elektromekanik
- 2 (dy) saldator
- 1 (nje) elektrikist
- 4 (kater) betonues
- 2 (dy) murator

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar. Stafin teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtoresh) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik si më sipër, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit, për natyrën komplekse të nderhyrjeve në këto objekt. Me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.

2.3.6 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë:

2.3.6.1 Punonjës të kualifikuar të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), të lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë:

- **10 (dhjete) punonjës manovrator te mjeteve te renda**

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional) te vlefshme, që të vërtetojë kualifikim profesional të kërkuar, referuar rregullores “*Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko praktike të kandidatëve, si dhe dhënie e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punimin e ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre*”, miratuar me urdhërinr.200, datë datë 16.05.2019 të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.6.2 Punonjës të kualifikuar të pajisur me Çertifikatë të Aftësive Profesionale (CAP), të lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë:

- **16 (dhjete) punonjës shofere te mjeteve me tonazh te larte**

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Certifikate të Aftësive Profesionale (CAP) te vlefshme, që të vërtetojë kualifikim profesional të kërkuar.

2.3.6.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë nëpërmjet listëpagesave dhe kontratave të punës se ka të punësuar në shoqëri **45 (dyzet e pesë) punëtorë krahu**.

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes se Formularit përmbledhës te vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar:

- **1 (një)** punonjës që të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"
- **1 (një)** punonjes pjesë e stafit inxhinierik si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", (i ndryshuar)

Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe 1 (një) "Për mbrojtjen e mjedisit".

Argumentimi Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Për kërkesat e pikës "a"; "b"; "c"; "d"; "e" mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"; V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"; ligjin Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe ne mbështetje te pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga zjari apo çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Argumentimi për drejtuesin teknik,*Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 " Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", konkretisht pika 1.2 ku citohet se: "drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi" si dhe pikës 2.1 ku citohet se "drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit".

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

Certifikatë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e Menaxhimit të cilësisë “ Lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ;

Certifikatë OHSAS 18001-2007 mbi “ Shëndetin dhe Sigurimin në punë “ lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim dhe /ose certifikatën ekuivalente të njohur nga standartet shshqiptare ISO 45001-2018.

Certifikatë ISO 39001:2012 mbi “Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor” Lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ;

Certifikatë ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit”, Lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ;

Certifikata sa më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara , të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit , i akredituar nga organizimi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues , të njohur nga Republika e Shqipërisë .

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit .

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik , çdo anëtar I grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes 20 Ton	në pronësi ose me qera	copë	6
2	Eskavator (me goma ose zinxhir)	në pronësi ose me qera	copë	3
3	Minieskavator /Ekuivalent	në pronësi ose me qera	copë	2
4	Eskavator me Zinxhir me cekic	në pronësi ose me qera	copë	2
5	Fadrome	në pronësi ose me qera	copë	4
6	Minifadrome /Ekuivalent	në pronësi ose me qera	copë	1
7	Gjysem rimorkio per transport mjetesh mbi 20 Ton	në pronësi ose me qera	copë	2
8	Autobetoniere	në pronësi ose me qera	copë	4
9	Autopompe Betoni	në pronësi ose me qera	copë	2
10	Kamionçinë me kapacitet mbajtes deri 5 Ton	në pronësi ose me qera	copë	2
11	Aparat topogjeodezik me GPS	në pronësi ose me qera	copë	1
12	Paisje gjeodezike tip Nivelues me aksesore perkates	në pronësi ose me qera	copë	1
13	Cekic per thyerje betoni	në pronësi ose me qera	copë	2
14	Autobot uji	në pronësi ose me qera	copë	1
15	Vibrator betoni	në pronësi ose me qera	copë	2
16	Autovinç me peshe mbi 60 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
17	Kthyes Hekuri	në pronësi ose me qera	copë	1
18	Gazogjen dhe Elektroorgano	në pronësi ose me qera	copë	2
19	Saldatriçe	në pronësi ose me qera	copë	1
20	Grejder	në pronësi ose me qera	copë	1

21	Rrul vibrues	në pronësi ose me qera	copë	4
22	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qera	copë	1
23	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qera	copë	1
24	Freze asfalti (skarifikim)	në pronësi ose me qera	copë	1
25	Trencher	në pronësi ose me qera	copë	1
26	Betoniere 0.5 m ³	në pronësi ose me qera	copë	3
27	Kompresor	në pronësi ose me qera	copë	3
28	Sistem Wellpoint	në pronësi ose me qera	copë	1
29	Pompe suvatimi	në pronësi ose me qera	copë	1
31	Makineri per vijejime (sperkates boje)	në pronësi ose me qera	copë	1

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera, duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga Administrator i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

2.3.15 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te disponojnë:

Impiant prodhim Inertesh me QKL dhe leje mjedisore	1 cope	Pronesi/ Qira ose kontrate furnizimi
Fabrike Betoni me QKL dhe leje mjedisore	1 cope	Pronesi/ Qira ose kontrate furnizimi
Fabrike Asfalti me QKL dhe leje mjedisore	1 cope	Pronesi/ Qira ose kontrate furnizimi

Përsa mësipër, OE duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë, të marrjes me qera, apo kontratën noteriale të furnizimit, të shoqëruara me leje mjedisore nga QKL.

- a) Per linjen e inerteve, fabrikën e betonit dhe fabrikën e asfaltit (qofshin ne pronesi, me kontrate qeraje apo kontrate furnizimi) duhet te paraqitet akti i pronësisë, leja mjedisore e leshuar nga QKL dhe fotot Referuar specifikimeve teknike te realizimit te objektit, Linja per prodhim inertesh te pajisur me leje mjedisore.

Ne kete rast operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin ligjor qe verteton pronesine e tij (fature tatimore/zhdoganimi ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqeruar me foto) ose ne rast se se disponon me qera te paraqese kontraten e qerase

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ,të gjithë dokumentacionin provues për makinëritë e mesipërme.

2.3.16 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet te paraqese **autorizim/kontrate bashkepunimi** nga prodhuesi ose distributori, me te cilin prodhuesi autorizon kompanine pjesmarrese ne tender te ofertoje keto pajisje / mallra ne kete procedure prokurimi si me poshtë:

-Tuba HDPE sipas preventivit.

Detyrimisht te paraqiten edhe kataloget perkates (originale dhe / ose te noterizuar). Produktet duhet te jene sipas standarteve te Komunitetit European (CE)/ekuivalent”.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet se, brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Shenim për operatorët ekonomik: Në bazë të nenit 26, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 (I ndryshuar) , ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Keto dokumenta duhet të paraqiten origjinalë ose ne kopje kopje të njehsuara te tyre me origjinalin.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Argumentimi:Kërkesat e mesiperme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Makineritë janë përcaktuar në raport me punimet e parashikuara në preventiv dhe volumet e tyre, numrin e puntorisë dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të kontratës.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:

“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” indryshuar, neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

“Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjete transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjete i transportit do të mbetet në qarkullim”.

Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se : “Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës.”

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pare dorëzimin e

dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.